



REPUBLIKA E KOSOVES/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO	
AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE ANTI-CORRUPTION AGENCY	
Dep. Dep. <u>2-D/DPK</u>	Nr. Prot. Br. Prot. <u>01-2902/15</u>
Nr. l faq. Broj stranica <u>02</u>	Data Datum <u>25.09.2015</u>
Nr. pages	Date



Republika e Kosovës Republika Kosova - Republic of Kosovo

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE
ANTI - CORRUPTION AGENCY

Në mbështetje të nenit 11 (paragrafi 1.1), nenit 5 (paragrafi 1 pika 1.5), nenit 18 (paragrafi 10 dhe 11) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit, si dhe nenit 19 (paragrafi 11) të Rregullores nr. 01/2014 së Punës të Agjencisë kundër Korrupsionit, Drejtori i Agjencisë kundër Korrupsionit me datë 18.09.2015, mori:

V E N D I M

I. Mbyllet rasti me nr. AKK-03-02-2199/15, për z. Salih Lajçi, Drejtor i Drejtorisë për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit në Komunën e Pejës, për shkak se zyrtari i lartë publik ka shmangur gjendjen e papajtueshmërisë dhe konfliktin e interesit në ushtrimin e funksionit publik.

II. Rasti mund të rihapet në çdo kohë kur mund të paraqiten rrethana të reja.

A r s y e t i m

Rasti i hapur nën dyshimin e bazuar për Konflikt Interesi në Ushtrimin e Funksionit Publik për zyrtarin e lartë, z. Salih Lajçi, Drejtor i Drejtorisë për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit në Komunën e Pejës, dhe njëkohësisht, person i autorizuar në një biznes privat, është trajtuar sipas procedurës së paraparë në Ligjin Nr. 04/L-051 për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik.

Zyrtari i lartë, fillimisht është njoftuar me një shkresë zyrtare nga Agjencia kundër Korrupsionit, për fillimin e shqyrtimit të gjendjes së mundshme të konfliktit të interesit, Pas pranimit të kësaj shkrese, kemi njoftuar zyrtarin e lartë për gjendjen e konfliktit të interesit në të cilin ndodhej.

Zyrtari i lartë z. Lajçi, ka pranuar rekomandimin e Agjencisë, për të bërë ndryshimet e nevojshme në Agjencinë për Regjistrimin e Bizneseve për të shmangur gjendjen e mundshme të konfliktit të interesit.

Ndërkohë, zyrtari i lartë z. Lajçi ka dërguar në Agjenci një shkresë zyrtare të lëshuar nga Agjencioni për Regjistrimin e Bizneseve në Kosovë (DPKI.03-01/2673/15) në të cilën vërtetohet se zyrtari i lartë është larguar nga funksioni i të qenurit person i autorizuar në biznesin privat Sh.P.K “Al – Filipen”.

II. Në mbështetje të nenit 18 (paragrafi 11) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit, Agjencia mund të rihap rastin në çdo kohë nëse paraqiten rrethana të reja.

Andaj u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi iu dërgohet:

- Zyrtarit të lartë publik
- Drejtorit të DPK- së
- Z./znj. (zyrtari përgjegjës)

Hasan Preteni
Drejtore i Agjencisë kundër Korrupsionit

